



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 13 prot.

Kamëz, më 22 .01. 2024

V E N D I M

Nr 13 Datë 22 / 01 / 2024

M B I

“OFRIMIN E SHËRBIMEVE QË PËRFITOHEN FALAS APO ME ÇMIME TË REDUKTUARA NË BASHKINË KAMËZ NGA PËRDORIMI I KARTËS SË STUDENTIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.10 Datë 18.01.2024 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, nenit 35, nenit 55, pikat 2 dhe pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenit 100 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së shërbimeve që ofrohen falas apo me çmime të reduktuara nga Bashkia e Kamëz, nga përdorimi i kartës së studentit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Përfitues të këtyre shërbimeve, janë studentët që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë, dhe të cilët janë pajisur me kartën e studentit.
3. Shërbimet e ofruara si dhe tarifat respektive të përcaktuar në këtë vendim, të reflektohen edhe në vendimet e Këshillit Bashkiak që normon shërbimet e caktuara në qytetin e Bashkisë Kamëz.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Bashkia Kamëz nëpërmjet strukturave përkatëse të ndjek të gjitha hapat dhe procedurat për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me palët e treta që do të ofrojnë shërbimet falas apo me çmime të reduktuara nga përdorimi i kartës së studentit.
5. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit, Rinsë dhe Sportit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Transportit dhe Liçensave, Pallati i Kulturës, si dhe çdo strukturë tjetër e Bashkisë Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI